

# Platforma për të Drejtat e Njeriut

## Goal: UJË I PASTËR DHE KANALIZIME

Sigurimi i furnizimit dhe i menaxhimit të qëndrueshëm të ujit dhe kanalizimeve për të gjithë.

### Target: 6.a

6.a Deri në vitin 2030, të zgjerohet bashkëpunimi ndërkombëtar dhe mbështetja për ngritjen e kapaciteteve në vendet në zhvillim lidhur me aktivitete dhe programe për ujin dhe kanalizimet, përfshirë dhe grumbullimin e ujit, shkrupëzimin, eficiencën e përdorimit të ujit, trajtimin e ujërave të zeza, teknologjitë e riciklimit dhe të ripërdorimit.

#### Instrumentet ndërkombëtare

#### Nenet

Neni 27

Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut  
Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut

1. Secili ka të drejtë të marrë pjesë lirisht në jetën kulturore të bashkësisë, të gëzojë artet dhe t' marrë pjesë në përparimin shkencor dhe në dobietë që sjell ajo.
2. Secili ka të drejtë të mbrojë interesat morale dhe materiale që rrjedhin nga çdo krijimtari shkencore, letrare ose artistike, krijues i të cilave është ai vetë.

Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut  
Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut

Neni 28

Të gjithë kanë të drejtë për një rend shoqëror dhe ndërkombëtar në të cilin të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Deklaratë mund të realizohen plotësisht.

**Instrumentet  
ndërkombëtare**

**Nenet**

**Neni 24**

Shtetet Palë njohin të drejtën e fëmijës për të gëzuar një gjendje shëndetësore sa më të mirë dhe për të përfituar nga shërbimet për trajtimin e sëmundjes dhe riaftësimin e shëndetit. Shtetet Palë përpiqen të sigurojnë që asnjë fëmijë të mos i mohohet e drejta për të pasur këto shërbime të kujdesit shëndetësor.

2. Shtetet Palë ndjekin zbatimin e plotë të kësaj të drejte dhe në veçanti marrin masat e duhura:

(a) Për të ulur vdekshmërinë foshnjore dhe fëmijërore;

(b) Për t'u siguruar të gjithë fëmijëve ndihmën e nevojshme mjekësore dhe kujdesin për shëndetin, duke e vënë theksin në zhvillimin e kujdesit shëndetësor parësor;

(c) Për të luftuar sëmundjen dhe kequshqyerjen, edhe në kuadrin e kujdesit shëndetësor parësor, me anë të përdorimit, ndër të tjera, të teknikave lehtësisht të arritshme si dhe të sigurimit të produkteve ushqimore të përshtatshme dhe ujit të pijshëm të pastër, duke pasur parasysh rreziqet e ndotjes së mjedisit natyror;

(d) Për t'u siguruar nënave kujdesin e duhur shëndetësor, para dhe pas lindjes;

(e) Për të mundësuar që gjithë grupet shoqërore dhe në veçanti prindërit dhe fëmijët të marrin informacion, të kenë mundësi edukimi dhe të përkrahen për të përdorur dijet bazë për shëndetin dhe të ushqyerit e fëmijës, përparësitë e ushqyerjes me gji, higjienën dhe shëndoshjen e mjedisit dhe parandalimin e aksidenteve;

(f) Për të zhvilluar kujdesin shëndetësor parandalues, këshillimin e prindërve, edukimin dhe shërbimet në fushën e planifikimit familjar.

3. Shtetet Palë marrin të gjitha masat e efektshme dhe të nevojshme për të zhdukur praktikat tradicionale të dëmshme për shëndetin e fëmijëve.

4. Shtetet Palë marrin përsipër të nxisin dhe inkurajojnë bashkëpunimin ndërkombëtar, me qëllim që të sigurojnë gradualisht realizimin e plotë të së drejtës së njohur në këtë nen. Për këtë, mbahen parasysh në mënyrë të veçantë nevojat e vendeve në zhvillim.

**Neni 4**

Konventa për të Drejtat  
e Fëmijës  
Konventa për të Drejtat  
e Fëmijës

Shtetet Palë angazhohen të marrin të gjitha masat legislative, administrative e të tjera të nevojshme, për të vënë në jetë të drejtat e njohura në këtë Konventë. Lidhur me të drejtat ekonomike, shoqërore e kulturore, Shtetet Palë marrin të gjitha masat e mundshme, në bazë të burimeve që disponojnë dhe, kur është nevoja, në kuadrin e bashkëpunimit ndërkombëtar.

**Ligjet**            **Nenet**

Nuk ka rezultat